



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR LEZHË

Nr. 843 Prot.

Lezhë më 15.06.2026

NJOFTIM

**MBI APLIKIMIN PËR LËVIZJE PARALELE ME DËSHIRË, PËR PUNONJËSIT
MËSIMOR TË PUNËSUAR ME KONTRATË ME AFAT TË PACAKTUAR NË
NË ZVAP NË VARËSI TË DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR LEZHË**

Bazuar në Ligjin Nr.69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 08, datë 03.05.2024, “Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimit të portalit “Mësues për Shqipërinë” i ndryshuar, njoftojmë fillimin e procedurave të aplikimit për lëvizje paralele sipas afateve të mëposhtme:

Aplikimi i kandidatëve :

- Mësuesi i punësuar me kontratë pune me afat të pacaktuar, që dëshiron të kryejë lëvizje paralele para fillimit të vitit mësuesor 2026-2027 brenda ZVAP-së ku është i punësuar, aplikon nga data **15 Qershor 2026 - 30 Qershor 2026**.
- Adresat e emaili ku do të dërgoni dokumentat e aplikimit sipas shtojcës 2 të këtij udhëzimi janë si vijon:

Email:

DRAP Lezhë: Levizjeparalele.draplezhe@arsimi.gov.al

Adresa: Sheshi " Gjergj Kastrioti", Godina QKF " Gjergj Lacaj" Kati 2, DRAPLezhe@arsimi.gov.al

Dokumentacioni i aplikimit :

1. Mësuesit që dëshirojnë të kryejnë lëvizje paralele, dërgojnë në adresën e emailit dokumentacionin e përcaktuar në shtojcën 2 të udhëzimit.
 - a) Formulari i aplikimit **(i detyrueshëm për t'u ngarkuar)**. **Për mësuesit të cilët kanë diplomat të profilit biologji-kimi, histori-geografi, matematikë –fizikë, kandidati duhet të përzgjedh në formular profilin në të cilin do të rankohet nga KVD e DRAP Lezhë)**
 - b) kartën e identitetit **(e detyrueshëm për t'u ngarkuar)**.
 - c) Kopje e diplomës/ave, vërtetimit/listës së notave të studimeve të larta (cikli i parë dhe cikli i dytë) ose të barasvlershme me këto sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi **(i detyrueshëm për t'u ngarkuar)**.
 - d) Kopje e licencës së provimit të shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit, për të gjithë kandidatët që kanë detyrim ligjor ta kryejnë këtë provim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi **(i detyrueshëm për t'u ngarkuar)**.
 - e) Formular të vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore, sipas modelit të shtojcës 3, të këtij udhëzimi; **(i detyrueshëm për t'u ngarkuar)**.
 - f) Deklaratë nga kandidati për autorizimin e institucionit arsimor që të shqyrtojë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura sipas modelit të shtojcës 4, të këtij udhëzimi; **(i detyrueshëm për t'u ngarkuar)**.
 - g) Kopje e librezës së punës **(e detyrueshëm për t'u ngarkuar)**.
 - h) Kopje e dëshmimeve të kualifikimit për kategoritë: “Mësues i kualifikuar”, “Mësues specialist”, “Mësues mjeshtër” **(nëse ka dhe dëshiron të vlerësohet me pikë)**.
 - i) Kopje e certifikatave me kredite të trajnimeve të kryera brenda dhe jashtë vendit. Certifikatat me kredite të trajnimeve të kryera brenda vendit të jenë ofruar nga MAS, institucionet e varësisë ose nga agjencitë e akredituara. **(nëse ka dhe dëshiron të vlerësohet me pikë.)**
 - j) Kopje e dëshmisë së njohjes së gjuhës/ve të huaja **(nëse ka dhe dëshiron të vlerësohet)**.
 - k) Vlerësimi i përfaqësuesve të prindërve (sipas shtojcës 5).
 - l) Vlerësimi nga punonjësi/it e shërbimit psiko-social, sipas pikës 7 të shtojcës 2
 - m) Vlerësimi i drejtorit të institucionit arsimor, sipas pikës 8 të shtojcës 2
2. Kandidati, dosja e të cilit nuk përmban një nga dokumentet e detyrueshme nuk kualifikohet.

Afatet e njoftimit të kandidatëve:

1. KVD-ja e DRAP Lezhë, brenda datës 20 korrik, vlerëson dosjet e kandidatëve që kanë aplikuar për lëvizje paralele me dëshirë. Rezultatet e vlerësimit paraprak publikohen në faqen e DRAP Lezhë dhe të ZVAP-ve në varësi, si dhe i dërgohen me email çdo aplikanti.
2. Kandidati që ka aplikuar për lëvizje paralele brenda të njëjtës ZVAP, ka të drejtë të paraqesë ankesë në DRAP për rezultatin paraprak, brenda 3 (tri) ditëve nga marrja e njoftimit të rezultatit., nga data 21.07.2026 - 23.07.2026
3. KVD-ja e DRAP Lezhë, brenda 3 (tri) ditëve pune, shqyrton ankesat dhe i njofton me *email* çdo kandidati rezultatin përfundimtar të vlerësimit të dosjes për lëvizje paralele. nga data 24.07.2026 - 28.07.2026
4. KVD-ja e DRAP Lezhë shpall dhe publikon listën e kandidatëve që kanë aplikuar për lëvizje paralele me dëshirë, me pikët përkatëse të secilit pas ankimimit brenda datës 30.07.2026.
5. KVD-ja e DRAP Lezhë rendit për çdo ZVAP sipas profileve, mësuesit që kanë ngelur pa ngarkesë mësimore dhe mësuesit që kanë bërë kërkesë për lëvizje paralele në të njëjtën ZVAP. Këto lista i publikon në faqen zyrtare të DRAP Lezhë, si dhe i dërgon për publikim në ZVAP-in përkatës brenda datës 01.09.2026.
6. Vendet e lira të punës që janë krijuar brenda një ZVAP-je u ofrohen për punësim mësuesve të cilët kanë ngelur pa ngarkesë mësimore (lëvizje paralele e detyruar) brenda datës 04. 09 2026.
7. Vendet e lira të punës të mbetura pas lëvizjes paralele me detyrim, brenda një ZVAP-je u ofrohen për punësim mësuesve të cilët kanë aplikuar për lëvizje paralele me dëshirë, sipas profileve dhe renditjes, brenda datës 04 .09. 2026.
8. Në rast se në ZVAP-të e tjera të DRAP Lezhë rezulton se pas njoftimit për punësim, ka vende të lira pune, atëherë këto vende u ofrohen kandidatëve të papunësuar të të gjitha ZVAP-ve në juridiksion, të cilët kanë ngelur pa ngarkesë mësimore, sipas profileve, duke filluar me kandidatin me më shumë pikë, brenda datës 08 .09.2026.

HASAN MUÇA



Adresa: Sheshi " Gjergj Kastrioti", Godina QKF "Gjergj Lacaj" Kati 2, DRAPLezhe@arsimi.gov.al



Aneksi nr.1

Ndarja territoriale

I. DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR LEZHË
(Adresa: Sheshi "Gjergj Kastrioti", kati 2, godina QKF "Gjergj Lacaj", Lezhë)

<u>Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar</u>
Has
Tropojë
Mirditë
Malësi e Madhe
Vau Dejës
Pukë – Fushë Arrëz
Kukës
Lezhë
Kurbin
Shkodër



FORMULARI I APLIKIMIT PËR LËVIZJET PARALELE

NID*:

Emri*:

Mbiemri*:

Nr. Cel*:

Email*:

DRAP*:

ZVAP*:

Shkolla ku është i/e punësuar*:

Profili* :

Adresa: Sheshi " Gjergj Kastrioti", Godina QKF " Gjergj Lacaj" Kati 2, DRAPLezhe@arsimi.gov.al



SHTOJCA 2

KRITERET DHE SKEMA E VLERËSIMIT TË DOSJEVE TË KANDIDATËVE PËR LËVIZJET PARALELE

1	Nota mesatare e studimeve të larta, e shprehur në numër me një shifër pas presjes dhjetore (nota mesatare e ciklit I + nota mesatare e ciklit II)/2, ose nota mesatare e studimeve të barasvlershme me to. Vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme: Nota mesatare 5.00 - 5.50 = 0.5 pikë; Nota mesatare 5.51 - 6.00 = 1 pikë; Nota mesatare 6.01 - 6.50 = 1.5 pikë; Nota mesatare 6.51 - 7.00 = 2 pikë; Nota mesatare 7.01 - 7.50 = 2.5 pikë; Nota mesatare 7.51 - 8.00 = 3 pikë; Nota mesatare 8.01 - 8.50 = 3.5 pikë; Nota mesatare 8.51 - 9.00 = 4 pikë; Nota mesatare 9.01 - 9.50 = 4.5 pikë; Nota mesatare 9.51 - 10.00 = 5 pikë.	0.5–5 pikë
2	Kategoria e kualifikimit: a) Mësues i Kualifikuar (kategoria III) 1–4 pikë (1 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”, 2 pikë për vlerësimin “Mirë”, 3 pikë për vlerësimin “Shumë mirë” dhe 4 pikë për vlerësimin “Shkëlqyeshëm”); b) Mësues Specialist (kategoria II) 5–7 pikë (5 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”, 6 pikë për vlerësimin “Mirë”, 7 pikë për vlerësimin “Shumë mirë” dhe “Shkëlqyeshëm”); c) Mësues Mjeshtër (kategoria I) 8–10 pikë (8 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”, 9 pikë për vlerësimin “Mirë”, 10 pikë për vlerësimin “Shumë mirë” dhe “Shkëlqyeshëm”) Për kandidatët që nuk e kanë në dëshmi nivelin e vlerësimit, do të llogaritet niveli “Shumë mirë”. Kandidati vlerësohet vetëm për kategorinë më të lartë të kualifikimit që zotëron. Kandidati që nuk ka kategori kualifikimi vlerësohet me zero pikë.	0–10 pikë
3	Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja: a) Gjuhë e huaj e mbrojtur në IAL-të publike = 1 pikë; b) Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B1 = 1 pikë; c) Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B2 = 2 pikë. Dokumenti i gjuhës së huaj duhet të jetë lëshuar nga subjekte të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, për ofrimin e testeve ndërkombëtare dhe të jetë brenda afatit të vlefshmërisë. Lista e subjekteve është sipas udhëzimit nr. 52, datë 3.12.2015, i ndryshuar. Pavarësisht se kandidati mund të ketë disa gjuhë të huaja të mbrojtura, në këtë rubrikë nuk mund t'i llogariten më shumë se 2 pikë në vlerësimin e dosjes. Në rast se kandidati ka mbrojtur të njëjtën gjuhë të huaj në dy institucione të ndryshme, do t'i llogariten pikë vetëm për dëshminë me vlerësimin më të lartë. Kandidatit të profilit gjuhë e huaj, i njihen pikët e kësaj rubrike, përveç gjuhës së huaj për të cilën është diplomuar. Kandidati që nuk zotëron dëshmi të gjuhës së huaj, vlerësohet me zero pikë.	0–2 pikë



4	Trajnime. Vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme: a) Certifikata trajnimesh me kredite të lëshuara nga institucione në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit ose nga agjenci trajnuese që janë akredituar nga ministria përgjegjëse për arsimin. i. 1 kredit = 1 pikë; ii. 2 kredite = 2 pikë; iii. mbi 3 kredite = 3 pikë. Kandidati që nuk zotëron certifikata trajnimi, vlerësohet me zero pikë.	0–3 pikë
5	Përvoja në punë si mësimpldhënës dhe/ose drejtues institucioni arsimor. Kandidati që nuk ja përvojë pune si mësues dhe/ose drejtues institucioni arsimor, vlerësohet me zero pikë.	(0.25 pikë për çdo vit pune
6	Vlerësimi i përfaqësuesve të prindërve (sipas shtojcës 5). Përfaqësuesit e prindërve të nxënësve, ku mësuesi jep mësim, vlerësojnë punën e këtij mësuesi me nivelet: “Shumë mirë”, “Mirë”, “Mjaftueshëm”, “Dobët”, si vijon: Vlerësimi “Shumë mirë” dhe “Mirë” = 2 pikë; Vlerësimi “Mjaftueshëm” = 1 pikë; Vlerësimi “Dobët” = 0 pikë.	0–2 pikë
7	Vlerësimi nga punonjësi/it e shërbimit psiko-social. Punonjësi/it e shërbimit psiko-social vlerësojnë punën e mësuesit me nivelet: “Shumë mirë”, “Mirë”, “Mjaftueshëm”, “Dobët” si vijon: Vlerësimi “Shumë mirë” dhe “Mirë” = 2 pikë; Vlerësimi “Mjaftueshëm” = 1 pikë; Vlerësimi “Dobët” = 0 pikë.	0–2 pikë
8	Vlerësimi i drejtorit të institucionit arsimor, bazuar në vlerësimin e performancës, e shprehur në nivelet: “Shumë mirë”, “Mirë”, “Mjaftueshëm”, “Dobët”, si vijon: Vlerësimi: “Shumë mirë” dhe “Mirë” = 2 pikë; Vlerësimi: “Mjaftueshëm” = 1 pikë; Vlerësimi: “Dobët” = 0 pikë.	0–2 pikë



SHTOJCA 3

VETËDEKLARIMI I GJENDJES GJYQËSORE

Të dhënat e vetëdeklaruesit:

Emër, atësi, mbiemër: _____

Datëlindja: _____

Vendlindja: _____

Dokumenti i identifikimit (kopje bashkëlidhur formularit)

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam: _____

i/e padënuar i/e dënuar

Deklaroj me vullnetin tim të lirë, se nuk kam qenë asnjëherë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale kundrejt të miturve apo për kryerjen e një vepre penale, që lidhet me institucionet arsimore, apo i rehabilituar për këto vepra penale.

Emër, mbiemër: _____ Nënshkrimi: _____



DEKLARATË PËR VERIFIKIMIN E VËRTETËSISË SË DOKUMENTEVE TË PARAQITURA NGA KANDIDATI

Unë _____, kandidat në procesin e konkurrimit për
lëndën/profilin “_____”, të zhvilluar në vitin shkollor _____ -
_____, autorizoj DRAP-në _____ të verifikojë në çdo kohë vërtetësinë e
dokumenteve të paraqitura nga ana ime.

Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së
tyre nga institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar.

Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet në përputhje me ligjin
nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

AUTORIZUESI



MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR _____
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR _____
INSTITUCIONI ARSIMOR PARAUNIVERSITAR _____

Nr. _____ prot. _____, më _____.202_

PROCESVERBAL I DOKUMENTIMIT TË OPINIONIT TË KËSHILLIT TË PRINDËRVE PËR
MËSUESIN/EN _____
PROFILI _____,

Sot në datën _____.202_, ora ____:____, bazuar në ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; në ligjin nr. 69/2012, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe në udhëzimin nr. _____, datë _____, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, "Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit 'Mësues për Shqipërinë'", u mbledh Këshilli i Prindërve në shkollën _____ për të dhënë opinion për mësuesin/en, z./znj. _____, profili _____, dhe për performancën e tij/saj në procesin mësimor-edukativ, sjelljen dhe etikën në institucionin arsimor.

Në mbledhje morën pjesë _____ prindër nga _____ prindër gjithsej.

Opinion i prindërve mbi mësuesin/en z./znj. _____ është:

1. Dobët 2. Mjaftueshëm 3. Mirë 4. Shumë mirë

Anëtarët e pranishëm në Këshillin e Prindërve:

1. _____ 2. _____ 3. _____

Rezultati i vlerësimit për këtë mësues është: _____

U votua me _____ pro, dhe _____ vota kundër, me votim të fshehtë.

Mbajti procesverbalin

DREJTOR



SHTOJCA 6

FORMULAR DEKLARIMI PËR KONFLIKTIN E INTERESIT

Deklaruesi: z./znj. _____

Pozicioni aktual i punës: _____

Vendi i punës: _____

Unë nënshkruesi _____
(emër, atësia, mbiemër)

Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Dosjeve për fazën e konkurrimit me dosje për pozicionin e mësuesit në institucionet arsimore parauniversitare publike _____, deklaroj, nën përgjegjësinë time të plotë, se _____ në kushtet e konfliktit të interesit që parashikon legjislacioni në fuqi për konfliktin e interesave.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklarimit.

Datë _____._____._____

Nënshkruesi _____
(emër, mbiemër, firmë)